



Komuna e Shtimes



Shoqata Jetimat e Ballkanit

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

**BASHKËFINANCIM TË NDËRTIMIT TË SHTËPIVE FAMILJEVE NË NEVOJË NË
KOMUNËN E SHTIMES**

e lidhur ndërmjet

KOMUNA E SHTIMES,

me seli në Shtime, Rr. "Tahir Sinani", nr. 50, e përfaqësuar nga z. Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

dhe

SHOQATËS BËMIRËSE "JETIMAT E BALLKANIT",

me seli në Prizren, rr. "Bekim Muhaxheri" Nr.18, të cilën e përfaqëson Berat Kabashi, Drejtor i Shoqatës (në tekstin e mëtejme Shoqata)

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje është pajtueshmëria për bashkëfinancim dhe angazhim të ndërsjellë të Komunës së Shtimes dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” për sigurimin e përbashkët të mjeteve financiare , me qëllim të ndërtimit të 30-të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, sociale dhe të banimit.

Neni 2

Procesi

- Në përputhje me çështjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duke iu përmbajtur dispozitave ligjore, palët pajtohen që bashkërisht të promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në aspektin profesional, logjistik, financiar dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me Marrëveshje.
- Përzgjedhja e Operatorit punëkryes për ndërtimin e shtëpive do të jetë obligim i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, e cila do t’ia dorëzoj Komunës një kopje të Marrëveshjes, në të cilën do të jetë e përfshirë edhe kostoja totale e një shtëpie.
- Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Shoqatën, formon komisionin për pranimin e punëve të kryera, sipas raportit të zyrtarit përgjegjës, i cili caktohet nga Kryetari i Komunës në cilësinë e organit mbikëqyrësis, lidhur me realizimin e kësaj marrëveshje.

Neni 3

Zotimet e palëve

1. Komuna e Shtimes zotohet:

- Të merr përsipër participimin me mjete financiare në shumë 150,000.00 €, për ndërtimin e 30 shtëpive të banimit, përkatësisht 5,000.00 € për secilën shtëpi që do të ndërtohen.
- Komuna zotohet që shumën e cekur në pikën (1) një të këtij neni të realizojë në tre vite dhe atë për vitin 2023 participon projektin në vlerë 25.000.00€, pas rishikimit të Buxhetit në muajin qershor dhe aprovimit nga Kuvendi, ndërsa nëse nuk mund të realizohet kjo shumë për këtë vit, do të bartet në Buxhetin e vitit të ardhshëm, ndërsa për vitin 2024 në vlerë prej 50.000.00 € dhe për vitin 2025, 75,000.00€
- Që mjetet e cekura në pikën (1) një dhe (2) dy të këtij neni do të ndahen nga buxheti i Komunës së Shtimes dhe do të transferohen në llogarinë bankare të Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” Nr.XK051110318280000140 në Pro Credit Bank.
- Që ekzekutimi i pagesës për pjesën e mjeteve financiare që do të ndahen dhe transferohen nga buxheti i Komunës , do të realizohet pas fillimit të punimeve.
- Të sigurojë kushte të nevojshme për ndërtimin e shtëpive sipas kësaj Marrëveshje, duke përfshirë dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të autorizimeve që ka si institucion publik.

- Kryetari i Komunës me vendim cakton zyrtarin përgjegjës në cilësinë e organit mbikëqyrës në përcjelljen e realizimit të kësaj Marrëveshje.

2. Shoqata “Jetimat e Ballkanit” zotohet:

- Të merr përsipër ndarjen e mjeteve financiare për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpive të cekura sipas kësaj Marrëveshje.
- Të dorëzojë projektin e detajuar të shtëpive që do të ndërtohen si dhe një kopje të kontratës të lidhur mes Shoqatës dhe punëkryesit për ndërtimin e shtëpive, ndërsa në rast të çfarëdo ndryshimi eventual gjatë ndërtimit të shtëpive, e njofton paraprakisht Komunën dhe njëkohësisht kërkon pëlqimin paraprak.
- Që për pjesën e mjeteve financiare që do të ndahen nga buxheti i Komunës së Shtimes, Shoqata do të dërgojë në Komunë deklaratën e koston financiare për ndërtimin e shtëpive sipas kësaj Marrëveshje.
- Të dorëzojë raportin në Komunë, pas ndërtimit të çdo shtëpie.
- Të lejojë papengueshëm, qasjen e organit mbikëqyrës për përcjelljen e punimeve, deri në përfundimin e tërësishëm të ndërtimit të shtëpive.
- Të merr përsipër çdo punë shtesë përfshirë edhe kostot eventuale financiare.

Neni 4

Zotimet e përbashkëta të palëve

Palët pajtohen që:

- Të veprojnë me besim të plotë në arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshje.
- Për çfarëdo ndryshimi, plotësimi apo ndonjë mosmarrëveshje eventuale, të njëjtat t’i zgjidhin me mirëbesim, në formë të shkruar përmes një aneks-marrëveshjeje.
- Përzgjedhjen e familjeve përfituese që do t’iu ndërtohen shtëpitë e banimit, ta bëjë një komision i përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e Komunës së Shtimes dhe ata Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hartohet në 4 kopje identike (nga 2 për palët nënshkruese) dhe e njëjta hyn fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Qemajl Aliu

Kryetar i Komunës së Shtimes

Palët nënshkruese
Shtime, datë: _____

Berat Kabashi

Drejtor i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”

